



## UDHËZIM

# Mbi Pirjen e Duhanit në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A

Fushë Kosovë

Mars 2015

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr. 52 të mbajtur më 13 dhe më 17.03.2015 miratoi këtë:

## **U D H Ë Z I M**

### **Mbi pirjen e duhanit në Hekurudhat e Kosovës –Trainkos- Sh.A**

#### **Neni 1**

Me synim të mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve nga pasojat e konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit me këtë udhëzim përcaktohen masat për ndalimin e pirjes së duhanit me qëllim për të siguruar të gjithë punëtorët që të jenë të mbrojtur në mënyrë të barabartë dhe të efektshme nga ekspozimi i tymit të duhanit në hapësirat e mbyllura të objekteve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos- SH. A.

#### **Neni 2**

Hekurudhat e Kosovës -Trainkos- SH. A është kompani publike e cila duhet të veproi në pajtim me Ligjin për Kontrollin e Duhanit nr. 04/L-156.

#### **Neni 3**

Konform nenit 11 pikës 1 (1.1, 1.2,1.3) dhe pika 3(3.2) të Ligjit nr. 04/L-156, Hekurudhat e Kosovës –Trainkos- SH. A janë të obliguara që të ndalojnë pirjen e duhanit në hapësirat e punës .

#### **Neni 4**

Pirja e duhanit mund të lejohet vetëm në vendet e caktuara për pirjen e duhanit në pajtim me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Kontrollin e Duhanin nr. 04/L-156.

#### **Neni 5**

Hapësirat e parapara për pirjen e duhanit janë hapësirat e jashtme si ballkonet, terasat si dhe hapësirat e jashtme para hyrjeve të objekteve të punës të përcaktuara si në vijim:

- Në ndërtesën e Administratës së HK –Trainkos- SH. A: Hapësira para hyrjeve të ndërtesës.
- Objekti i tërheqjes se trenave: Para hyrjes së objektit.
- Punëtorja e lokomotivave: Në hapësirën në mes të objektit dhe para hyrjes së objektit.
- Punëtorja e vagonëve: Para hyrjeve të punëtorisë.
- Punëtorja e trenave motorik: Para hyrjeve të punëtorisë.

## **Neni 6**

Pirja e duhanit mund të bëhet gjatë kohës së pauzave në përputhje me orarin e punës.

## **Neni 7**

Punonjësit duhet të racionalizojnë maksimalisht pirjen e duhanit gjatë orarit të pauzave në hapësirat e hapura.

## **Neni 8**

Të gjithë të punësuarit në Hekurudhat e Kosovës –Trankos- Sh.A janë të obliguar që të veprojnë në pajtim me këtë udhëzim nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

## **Neni 9**

Menaxhmenti i Hekurudhave të Kosovës –Trainkos- Sh.A do të vendos mbishkrimin mbi ndalimin e pirjes së duhanit në të gjitha hapësirat ku ndalohet pirja e duhanit konform nenit 12 pika 1(1.1) të Ligjit nr. 04/L-156 Për Kontrollin e Duhanit.

## **Neni 10**

Drejtorët, menaxherët, stafi dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt duhet të mbikëqyrin zbatimin e këtij udhëzimi nga ana e vartësve të tyre konform nenit 12 pika 1(1.2,1.3,1.4) të Ligjit nr. 04/L-156. Për çdo shkelje eventuale do të aplikohen dënimet me gjobë konform nenit 12 pika 1(1.5) dhe nenit 21 pika 4 (4.1,4.3) të parapara në ligjin nr. 04/L-156 Për Kontrollin e Duhanit.

## **Neni 11**

Spektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore do të mbikëqyrin zbatimin e këtij Udhëzimi nga momenti i hyrjes në fuqi.

## **Neni 12**

Udhëzimi hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës- Trainkos- SH.A. dhe fillon të zbatohet nga data 01.042015.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi i mëparshëm.

  
Heset Cakolli  
Kryesues i Bordit të HK Trainkos Sh.A